



|                                        |              |
|----------------------------------------|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |              |
| KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN     |              |
| Nr. / Br.                              | 27545/26     |
| Nr. i fq. / Br. st.                    | -2-          |
| Data: / Datum:                         | 01. 07. 2026 |
| VUSHTRRI - VUÇITRN                     |              |



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

**Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**

**NJOFTIM ME RËNDËSI ME RASTIN E KORRJE-SHIRJEVE**

Njoftojmë të gjithë fermerët, autokombanjerët dhe bujqit e përfshirë në procesin e korrje-shirjeve që gjatë sezonit të respektojnë masat e sigurisë për parandalimin e zjarreve, mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit, si dhe zhvillimin e sigurt të punimeve në terren.

Duke ju bërë thirrje për mobilizim të plotë dhe kujdes maksimal gjatë punës, ju rekomandojmë t'u përmbaheni udhëzimeve në vijim:

1. Çdo parcelë e mbjellë me grurë duhet të korret plotësisht.
2. Mos lini asnjë sipërfaqe të pakorrur, pavarësisht madhësisë së saj.
3. Çdo zonë e nisur duhet të përfundohet tërësisht para se të zhvendoseni në parcelën tjetër.
4. Koordinohuni me fermerët dhe bujqit përreth për organizim dhe efikasitet më të mirë të punimeve.
5. Kontrolloni gjendjen teknike të autokombajnave, traktorëve dhe makinerive të tjera bujqësore për të shmangur defektet dhe rrezikun e zjarrit.
6. Sigurohuni që makineritë bujqësore të jenë të pajisura me aparat funksional për shuarjen e zjarrit dhe mjete të tjera të nevojshme për ndërhyrje të shpejtë.
7. Pastroni rregullisht makineritë nga mbetjet e kashtës, pluhuri dhe materialet e ndezshme që mund të shkaktojnë zjarr.

**Ndalohen rreptësishtë**

- Djegia e kashtës, mbetjeve bimore dhe sipërfaqeve bujqësore pas korrjes.
- Hedhja e cigareve ose përdorimi i flakës së hapur pranë parcelave.
- Çdo veprim që mund të shkaktojë zjarr dhe të rrezikojë jetën, pronën apo mjedisin.

Kujtojmë se djegia e sipërfaqeve bujqësore është e ndaluar dhe e dënueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast të zjarrit

- Njoftoni menjëherë Shërbimin e Zjarrfikësve në numrin 193 ose Qendrën Emergjente 112.
- Largohuni nga zona e rrezikut dhe ndiqni udhëzimet e autoriteteve kompetente.
- Ndërhyni vetëm nëse kjo mund të bëhet pa rrezikuar jetën tuaj.

Ky njoftim realizohet në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësinë e Zjarrfikësve dhe institucionet përgjegjëse, me qëllim parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të korrje-shirjeve dhe mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe për kontributin tuaj në sigurimin e bukës së vendit. Respektimi i këtyre masave është në interes të secilit prej nesh.

Besim Shyti



Drejtor i DBZHR-së